

## **ORGANET DREJTUESE**

1. Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

- **Asambleja e Përgjithshme**
- **Këshilli Mbikqyrës**
- **Administratori**

2. Përbërja, detyrat, të drejtat dhe funksionimi i Asamblesë së Përgjithshme dhe Këshillit Mbikqyrës janë sanksionuar në Ligjin nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe Statutin e Shoqërisë Albgaz Sh.A

3. Veprimtaria e zakonshme e Shoqërisë drejtohet nga Administratori i Shoqërisë.

4. Emërimi i Administratorit të shoqërisë bëhet nga Këshilli Mbikqyrës në përputhje me Statutin e shoqërisë.

5. Së bashku me funksionet e përcaktuara në Statutin e Shoqërisë Administratori ka të drejta dhe detyrat e mëposhtme:

### **I. ADMINISTRATORI**

#### **Ka të drejtë dhe detyrohet:**

- Të kryejë të gjithë veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Të përfaqësojë Shoqërinë tregtare;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;
- Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet për miratim Këshillit Mbikqyrës së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- Të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të Shoqërisë, sipas parashikimeve të Ligjeve në fuqi;
- Të raportojë përpara Këshillit Mbikqyrës për zbatimin e politikave dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut;
- Harton strukturën organizative të shoqërisë. Emëron Drejtorët dhe Përgjegjësit e Sektorëve të administratës qendrore të shoqërisë dhe Përgjegjësit e Stacioneve
- Përfaqëson shoqërinë Albgaz Sh.A në lidhjen e kontratës kolektive të punës me sindikatat e naftës dhe për zgjidhjen me ato të mosmarrëveshjeve që mund të lindin gjatë punës;
- Autorizon punonjës të veçantë të shoqërisë për ta përfaqësuar atë në marrëdhënie me të tretët;
- Për raste të veçanta, Administratori jep ndihma ekonomike në bazë të ligjit dhe Kontratës Kolektive të Punës.